



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë – Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice-Departamenti për
Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Committee

DPSDPLS.nr.14/2025

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga në përbërje nga Naim Mehulli kryesues, Ramush Bardiqi dhe Driton Govori, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj Përmbarueses Private [redacted] si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në [redacted] lidhur me veprimet përmbarimore në lëndët përmbarimore, P.nr.3256/2024, P.nr.3688/2024, P.nr.3589/2024, P.nr.3594/2024, P.nr.3587/2024, P.nr.3748/2024, P.nr.3790/2024, P.nr.3791/2024, P.nr.3696/2024, P.nr.3785/2024, P.nr.4561/2024, P.nr.4563/2024, P.nr.3686/2024, P.nr.3612/2024, P.nr.3628/2024, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Politika të sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika - Divizioni për Profesione të Lira dhe Statistika, Mimoza Blakaj, Përmbaruesi Privat dhe Arbresha Lajçi përfaqësuese e palës ankuese-Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Përmbaruesëve Privat, me datë 30.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

Organi përmbarues - Përmbaruesi Privat [redacted] si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore në [redacted] është përgjegjës për shkelje disiplinore, tejkallim i autorizimit të besuar me ligj, ashtu që të njëjtit i shqiptohet masa disiplinore, gjobë në të holla, në shumën prej 1,500.00 euro (njëmijë e pesëqind), të cilën detyrohet të paguajë në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, në llogarinë e Buxhetit të Odës së Përmbaruesëve, nën kërcënimin e përmbarimit.

Arsyetim

Divizioni Për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës së Profesioneve të Lira me datë 07.07.2025, ka parashtruar raportin e inspektimit të rregullt të kryer ndaj përmbaruesi privat me konstatimin dhe pretendimin se përmbaruesi privat ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Procedurën Përmbarimore, pasi nga raporti i inspektimit të rregullt që i është bërë përmbaruesit, është konstatuar se përmbaruesi privat ka bërë shkelje, duke tejkaluar autorizimet e tij ashtu që fillimisht lejin e përmbarimit e ka bere me dokumente kopje dhe se përmbarimi është bere në emër të kamatës ligjore e cila është llogaritur në shpenzime të procedurës kontestimore, respektivisht kamata 8% për shpenzimet e procedurës kontestimore e duke pas parasysh se kemi të bëjmë me kamatëvonesë për shpenzimet e procedurës kontestimore, përmbarimi nuk është i lejuar në këto raste. Në këtë mënyrë përmbaruesi ka vepruar njëjtët për këto lëndë: P.nr.3256/2024, P.nr.3688/2024, P.nr.3589/2024, P.nr.3594/2024, P.nr.3587/2024, P.nr.3748/2024, ndërsa për rastet P.nr.3790/2024, P.nr.3791/2024, P.nr.3785/2024, P.nr.3686/2024 përmbaruesi ka vepruar me një dokument jo të lejuar për përmbarim duke përdor dokumentin kopje si dokument përmbarimor dhe duke mos leshur faturë për arkëtimin e tarifave, po ashtu sa i përket rastve P.nr.3696/2024, P.nr.4561/2024, P.nr.4563/2024, P.nr.3612/2024, P.nr.3628/2024 dokumenti përmbarimor nuk ka parapa kamat ligjore prej 8% për borxhin kryesor. **Me propozim për komisionin që të aprovohet ankesa dhe të ndermirën masa ndaj përmbaruesit privat. Në seancën dëgjimore të datës 30.09.2025 përfaqësuesja e këtij divizion ka deklaruar se mbetet në tersi pran këtij raporti duke propozuar që përmbaruesit ti shqiptohet masa konfrm dispozitave të LPP-së**

Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, me datë 11.07.2025, ka paraqitur në Komision Disiplinor Raportin Përfundimtar, ndaj përmbaruesit private, si organ përmbarues, lidhur me veprimet e ndërmarra nga përmbaruesi privat në lëndën përmbarimore P.nr.3256/2024, P.nr.3688/2024, P.nr.3589/2024, P.nr.3594/2024, P.nr.3587/2024, P.nr.3748/2024, P.nr.3790/2024, P.nr.3791/2024, P.nr.3696/2024, P.nr.3785/2024, P.nr.4561/2024, P.nr.4563/2024, P.nr.3686/2024, P.nr.3612/2024, P.nr.3628/2024, me propozim që të ndërmerren veprimet e nevojshme lidhur me këtë rast. Po ashtu ne seancën e dt.30.09.2025 ka mbetur ne teri pran keti raporti dhe ka kërkuar të merret vendim meritior për këtë çështje.

Përmbaruesi Privat, në seancën dëgjimore të datës 30.09.2023, ka deklaruar se nuk e ndien veten përgjegjëse për asnjë nga veprimet e ndërmarra përmbarimore në këtë rast duke shtuar sipas asaj që u lexua dhe dëgjuam në sencë komisioni lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë së urdhrit përmbarimor, çka është shkelje flagrante e dispozitave të LPP ku përcaktojnë kompetencat për vlerësimin e ligjshmërisë se urdhrit i takon Gjykatës Themelore dhe të Apelit, ju i keni disa vendime që gjykata i ka refuzuar prapësimet dhe se përmbaruesi po sa i ka pranuar vendimet për refuzim të prapësimi ka dërguar urdhër ndërsa lëndët tjera sipas ligjit kanë marr formën e prerë

dhe nuk mund të vlerësohet nga ana e këtij komisioni, pra nuk është në kompetencë e këtij komisioni ti vlerësoj urdhrat përmbarimor që kanë marr formë të prerë, pasi LPP ka paraparë dispozita ligjore se si debitori mund ti realizoj të drejtat e tij nëse janë cenuar. I ka propozuar komisionit që të refuzohet ankesa.

Komisioni Disiplinor me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se përmbaruesi privat, ka kryer shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor gjen se përmbaruesi privat në këtë rast e ka tejkaluar autorizimet e tij me rastin e caktimit të përmbarimit në pjesën e propozimit ku kreditori ka kërkuar që të detyrohet debitori – pala ankuese, që t'i paguaj kamatën prej 8%, në vit. Kjo për faktin se me dokumentin përmbarues *“Pajtimet Gjyqësore dhe Aktgjykimet për urdhrat përmbarimor te lejuar nga përmbaruesi privat me numër P.nr.3256/2024, P.nr.3688/2024, P.nr.3589/2024, P.nr.3594/2024, P.nr.3587/2024, P.nr.3748/2024, P.nr.3696/2024, P.nr.4561/2024, P.nr.4563/2024, P.nr.3612/2024, P.nr.3628/2024 ”*, në bazë të secilës është caktuar dhe lejuar përmbarimi, nuk është përcaktuar dhe nuk buron detyrimi që debitori t'ia paguaj kreditorit asnjë shumë tjetër përveç borxhit kryesor, por jo edhe kamatën prej 8%, në vit ashtu siç ka kërkuar kreditori me propozim dhe që është lejuar përmbarimi, përveç kësaj për të gjitha urdhrat përmbaruesi ka vepruar me një dokument jo të lejuar për përmbarim duke përdor dokumentin kopje si dokument përmbarimor dhe duke mos leshur faturë për arkëtimin e tarifave duke i shkaktuar dëm palës debitore në përmbushjen e borxhit kryesor, për këto arsye komisioni vlerëson se përmbaruesi privat në këtë rast ka rënë ndesh me dispozitën e ligjore të nenit 367 paragrafi 1 nën paragrafi 1 i LPP-së.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e masës disiplinore, Komisioni Disiplinor mori parasysh të gjitha rrethanat e rastit, veçanërisht faktin peshën e dëmit të shkaktuar ndaj palës debitore, e cila ka ndikuar do të ndikonte në lartësinë e masës së shqiptuar. Komisioni Disiplinor vlerëson se masa e shqiptuar me gjobë në të holla bazuar në nenin 368 paragrafi 1 nën paragrafi 3 i LPP-së, i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë disiplinore të përmbaruesit, është e mjaftueshme dhe në përputhshmëri me karakteristikat rastit konkret si dhe në pajtim me parimin e proporcionalitetit, dhe i njëjti do të ndikojë në përmirësimin e shërbimeve e përmbarimore, të përmbaruesi privat si dhe tek përmbaruesit tjerë privat që t'u përmbahen dispozitave ligjore në përmbushjen e mandatit ligjor në ofrimin e shërbimeve përmbarimore në mënyrë profesionale dhe objektive, çka në thelb,

është edhe qëllimi i masës. Ndërsa, detyrimi se ku duhet të bëhet pagesa e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi, u bazua në nenin 11, të LIGJIT, NR. 08/L-102 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 05/L-118, përcaktohet se: “Neni 368 i ligjit bazik, paragrafi 3, togfjalëshi “në buxhetin e Republikës së Kosovës”, ndryshohen me togfjalëshin “në buxhetin e Odës së Përmbaruesve”, andaj gjoba e shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi duhet të paguhet në llogarinë e buxhetit të Odës së Përmbaruesve

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPSDPLS.nr 14/2025 datë 30.09.2025

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Naim Meholli



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.